



Nr. Ref. BD-230/38

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; neni 10.1. dhe 3 të Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të lokalit afarist "22 Dhjetori" në Rr. Kolashini pn, Mitrovicë Veriore, me sipërfaqe totale prej 149.98 m², sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 200.00 bruto në muaj për Administratën Tatimore të Kosovës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për refuzimin e qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim:

Ky vendim është marr duke u bazuar në faktet në vijim:

Lokali afarist "22 Dhjetori" i cili ndodhet në Rr. Kolashini në Mitrovicë veriore është pjesë e ndërtesës afariste-banesore. Sipas kontratës së shitblerjes nr. 1081 të datës 10 tetor 1977 ndërmjet ndërmarrjes BVI dhe NSh Lux lokali afarist ka sipërfaqe prej 149.98 m² dhe aktualisht është listuar apo kategorizuar si aset për tu privatizuar nga AKP në valët e ardhshme të shitjes.

Me datë 16 Korrik 2025 Agjencia ka pranuar shkresën me nr. protokoll 09064083, të parashtruar nga Administrata Tatimore e Kosovës, përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të këtij lokali afarist, për nevoja të akomodimit të institucioneve të Republikës së Kosovës. Aktualisht, lokali afarist është i mbyllur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit – ZR Mitrovicë.

Pasi që parashtrues i kërkesës është ATK konform nenit 10.3 të Rregullores Nr. 03/2025 çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të NSh-së. Mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për NSh këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSh-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

14/11





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2025




Mentor Hyseni
Kryesues
Bordit/Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-230/39

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023,), nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; Nenit 10.1.2 dhe 3 të Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të lokalit afarist “numër 138 në Rr. Millan Shuflai pn, Mitrovicë Veriore, me sipërfaqe totale prej 53 m2, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 50.00 bruto në muaj për Institucionin e Avokatit të Popullit për asetin e NSH “Gërmia” Prishtinë – PRN093.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimit të qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim:

Ky vendim është marr duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 18 korrik 2025 Agjencia ka pranuar shkresën me nr. protokolli 051/2025, të parashtruar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, përmes së cilës kanë adresuar kërkesën për marrje me qira të këtij lokalit afarist, për nevoja të akomodimit të institucioneve të Republikës së Kosovës. Me datë 22 korrik 2025 Agjencia, ka pranuar shkresën me nr. protokolli 052/2025, të parashtruar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, përmes së cilës kanë njoftuar se buxheti i planifikuar për marrje me qira të këtij aseti është 600 Euro/vit apo 50 Euro/muaj.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Institucioni i Avokatit të Popullit konform nenit 10.3 të Rregullores Nr. 03/2025 çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t’iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-230/40

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023,), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; Nenet 10.1.2 dhe 3 të Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënien direkte të ish Restaurant Taverna, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore NewCo Grand Hotel SH.P.K. – PRN173 (në likuidim), për realizimin e projektit kulturor, në bazë të kërkesës së Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), me çmim qiraje në shumën prej 1,210.00 Euro në muaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimit të qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim:

Ky vendim është marr duke u bazuar në faktet si në vijim:

Më 24.07.2025, Agjencia ka pranuar kërkesën zyrtare nga MKRS, me nr. protokolli 3681, për dhënien me qira të përkohshme të hapësirës, respektivisht ish Restaurant Taverna që ndodhet në kuadër të objektit të Hotelit Grand dhe ka qasje edhe nga pjesa e brendshme e hollit të Hotelit edhe qasje të drejtpërdrejt nga pjesa anësore e hotelit. Qëllimi i kësaj kërkesë është shfrytëzimi i kësaj hapësire për nevoja të shfrytëzimit për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, përkatësisht për inaugurimin e Muzeut të Artit Bashkëkohor (MAB) dhe shfrytëzimin e përkohshëm për ekspozimin e veprave artistike, derisa të përfundohen punimet në objektin e Rilindjes, hapësirë e cila i është ndarë këtij institucioni për shfrytëzim.

Muzeu i Artit Bashkëkohor (MAB) është institucioni më i ri publik qendror i kulturës në Kosovë. MAB-it i është ndarë një hapësirë për shfrytëzim nga Qeveria, respektivisht një hapësirë në kuadër të ish objektit të NSh Rilindja Shtypshkronja. Meqenëse kjo hapësirë është në fazat fillestare të projektimit dhe punimeve dhe së shpejti është paraparë të bëhet inaugurimi i MAB, ish Restaurant Taverna është kërkuar për qiramarrje të përkohshme me qëllim të inaugurimit dhe ekspozimit të veprave artistike.

Hapja e Muzeut të Artit Bashkëkohor ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin kulturor dhe shoqëror të vendit tonë. Ky institucion jo vetëm që ofron një hapësirë për ekspozimin dhe promovimin e artistëve bashkëkohorë, por gjithashtu shërben edhe si një urë lidhëse mes së kaluarës dhe së tashmes, duke reflektuar ndryshimet sociale, politike dhe kulturore të kohës sonë. Për më tepër, ai kontribuon në edukimin e brezave të rinj, zhvillimin e turizmit kulturor dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik për vlerat e artit modern. Në këtë mënyrë, hapja e një muzeu të tillë është një hap i rëndësishëm drejt afirmimit të identitetit kulturor dhe pjesëmarrjes aktive në skenën ndërkombëtare të artit.

Pasi që parashtrues i kërkesës është MKRS konform nenit 10.3 të Rregullores Nr. 03/2025 çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për



Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2025


Mentor Hysepi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-230/41

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin dhe), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; Nenet 10.1.2 dhe 3 të Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënien direkte të hapësirës në katin e tetë dhe të nëntë të Lamelës A, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore NewCo Grand Hotel SH.P.K. – PRN173 (në likuidim), për realizimin e projektit kulturor dhe dokumentues “Reporting House”, në bazë të kërkesës së Komunës së Prishtinës, me çmim qiraje në shumën prej 400.00 Euro në muaj.
- II. Kontrata e qirasë do të nënshkruhet ndërmjet Autoritetit të Likuidimit dhe Komunës së Prishtinës, me pjesëmarrje dhe përfshirje të organizatës realizuese të projektit – BIRN Kosovë – në cilësinë e bashkëpërgjegjëse për shfrytëzimin dhe funksionalizimin e hapësirës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin të qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim:

Ky vendim është marrë duke u bazuar në faktet si në vijim:

Më 23.07.2025, Agjencia \ ka pranuar kërkesën zyrtare të Komunës së Prishtinës, me nr. protokollit 3641, për dhënien me qira të përkohshme të hapësirës që ndodhet në katin e tetë dhe të nëntë të Lamelës A në objektin NewCo Grand Hotel SH.P.K. (në likuidim).

Qëllimi i kësaj kërkeje është shfrytëzimi i kësaj hapësire për nevoja të aktiviteteve kulturore dhe dokumentuese të Komunës së Prishtinës, konkretisht për vendosjen e përkohshme të Muzeut të Gazetarëve – “Reporting House”, i cili realizohet nga organizata BIRN Kosovë në bashkëpunim me institucione publike dhe donatorë ndërkombëtarë. Aktualisht, ky muze është i vendosur në hapësirat e ish-shtëpisë së mallrave “Gërmia” në Prishtinë dhe është hapur me rastin e 25-vjetorit të përfundimit të luftës në Kosovë. Brenda një viti funksionimi, ai është vizituar nga mbi 11,000 qytetarë dhe ka organizuar mbi 50 aktivitete publike, duke dëshmuar interes të madh dhe ndikim të gjerë në edukimin dhe informimin e publikut.

Projekti “Reporting House” është vlerësuar si një nismë me rëndësi të veçantë kulturore, edukative dhe historike, që synon ruajtjen e kujtesës kolektive përmes dokumentimit të raportimit mediatik gjatë luftës dhe periudhës së pasluftës, nëpërmjet arkivave vizuale, intervistave dhe ekspozitave multimediale.

Duke e mbështetur këtë iniciativë, Komuna e Prishtinës ka deklaruar gatishmërinë për të mbuluar qiranë mujore në shumën prej 400.00 € për hapësirën përkatëse, ndërsa renovimi dhe përshtatja e plotë e hapësirës – duke përfshirë funksionalizimin e ashensorëve, instalimet elektrike, sanitare dhe ndriçimin – do të realizohet nga organizata BIRN në bashkëpunim me partnerët dhe donatorët e saj ndërkombëtarë. Sipas vlerësimeve fillestare, ky investim pritet të kapë shumën rreth 100,000 €, ndërsa synimi përfundimtar është që hapësira të shndërrohet në një ekspozitë përhershme kushtuar historisë moderne të Kosovës.



Pasi që parashtrues i kërkesës është Komuna e Prishtinës konform nenit 10.3 të Rregullores Nr. 03/2025 çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që asetë do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevojat të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-230/42

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, dhe), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; Neni 10.1.3 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënien direkte, respektivisht kërkesa e Komunës së Prishtinës për dhënien me qira të parcelës me nr. kad. P-71914056-00044-7, me sipërfaqe prej 33,617 m², pronë e NSH "Bujqësia" – KBI Kosova-Export në likuidim, e klasifikuar si tokë bujqësore – kullosë e klasës së dytë, për përdorim të përkohshëm për qëllime publike dhe fetare të komunitetit vendor, me çmimin total prej 50.00 Euro në muaj, në përputhje me arsyetimin dhe relacionin përkatës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimit të qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim:

Komuna e Prishtinës ka paraqitur kërkesën për marrje me qira të përkohshme të parcelës kadastrale nr. 44-7 me sipërfaqe prej 23,617 m², e cila ndodhet në Zonën Kadastrale Orloviq, aktualisht e regjistruar në emër të NSH K.B.I. Kosova - Export. Në këtë parcelë ka nisur ndërtimi i një xhamie për nevojat e komunitetit lokal të fshatit Shkabaj. Për shkak të pamundësisë për të zhvilluar procedurat për shpalljen si parcelë me interes publik në një periudhë të shkurtër para zgjedhjeve lokale, Komuna ka kërkuar një marrëveshje të përkohshme qiradhënieje deri në përfundimin e procedurave përkatëse të transferimit. Komuna ka sqaruar se për shkak të kufizimeve buxhetore aktualisht mund të ofrojë një qira simbolike prej 50.00 euro në muaj për përdorimin e përkohshëm të parcelës.

Pasi që parashtrues i kërkesës është Komuna e Prishtinës konform nenit 10.3 të Rregullores Nr. 03/2025 çmimi i qiradhënies është përcaktuar në bazë të limiteve buxhetore që ka në këtë rast institucioni përkatës dhe duke pasur parasysh faktin që aseti do të shfrytëzohet në shërbim të interesit publik.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia-Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-230/43

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 06/L-023 dhe Ligjin nr. 05/L-080), nenit 18.1.3, nenit 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i Ligjit mbi AKP-në; Nenet 10.1.5 i Rregullores Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore; nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 200m² të pronës në pronësi të GJI059 NSH "Jugoterm" Gjilan, sipas buxhetit të Komunës në shumë prej Euro 160 qira mujore.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimit të qiradhënies direkte sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim:

Ky vendim është marr duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 14.07.2025 Agjencia ka pranuar Kërkesën për qiramarrje nga KK Novobërdë - Kryetari z. Sasa Milosevic. Me datë 13.06.2025 Kryetari i KK Novobërdë z. Sasa Milosevic ka dërguar një kërkesë për takim për negociim direkt – gjegjësisht ka kërkuar që të marr me qira hapësirat e pjesës së fabrikës - njësisë në fshatin Prekove, Komuna e Novobërdës. Gjatë bisedës telefonike me zyrën e tij i është kërkuar që të sjellë kërkesën zyrtare në zyrat e Agjencisë, Gjilan. Në kërkesën e sjellë me datën 14.07.2025 është theksuar nevoja – qëllimi i marrjes me qira të hapësirave të cekura më lartë e cila është funksionimi i pa penguar i kuzhinës popullore në të cilën do të përgatitet ushqimi për banorët që janë në kategorinë sociale të cënueshme. Buxheti i paraparë nga KK Novobërdë për këtë aset është Euro 160 në muaj ose Euro 1,920 në vit siç është theksuar në kërkesën e parashtruar të datës 14.07.2025. Pjesa e fabrikës (gjysma e hapësirës së brendshme të godinës) – Njësisë në fshatin Prekove, me një sipërfaqe prej 200m² – Pjesa e poshtme e hapësirës është e shtruar me çimento, ndërsa hapësira është e ndarë me muret montazhe ndarëse dhe janë shfrytëzuar si zyre nga qiramarrësi i mëparshëm i cili na kishte njoftuar për ndërprerje të kontratës duke filluar nga 1 qershor 2025. Pra të njëjtat hapësira objekt i vlerësimit (kërkesës) ishin të dhëna me qira për periudhën 1 dhjetor 2015 - 31 maj 2025.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së. Me qëllim të rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), këto fonde do të përdoren vetëm për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t'iu ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-230/44

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023), Rregullorja Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Tregu" dhe parashtruesve të këtyre kërkesave dhe Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e pjesëshëm të kontratës së qirasë tek NSh "NewCo Grand Hotel" Sh.p.k. (në likuidim):
Nga Flamur A. Kelmendi B.I., me emër tregtar N.T.P. "De Bona Auto", si qiramarrës i parkingjeve në NewCo "Grand Hotel", me sipërfaqe prej 202.37 m² (hapësirë mbi tokë – në hyrje të Grand Hotelit), në emër të ADV Facility Management, përfaqësuar nga Granit Gashi, me qira mujore prej 1,500.00 € (25.87%), ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes prej 1,096.09 m² (hapësirë nëntokësore) vazhdon të mbetet në qira në emër të Flamur A. Kelmendi B.I., me qira mujore përkatëse prej 4,298.00 € (74.13%), sipas kontratës ekzistuese dhe anekseve të saj.
- II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të që brenda periudhës deri në 6 muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, të paguajë, përpos qirasë mujore, edhe pjesën e borxhit për si në vijim:
Flamur A. Kelmendi B.I., me emër tregtar N.T.P. "De Bona Auto", si qiramarrës i parkingjeve në NewCo "Grand Hotel" Sh.p.k., para transferimit të një pjese të kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) në emër të ADV Facility Management, është i obliguar të shlyejë borxhin e papaguar në shumën prej 12,269.36 € (neto), pa përfshirë shpenzimet komunale për gjashtë muaj, ashtu që përpos shumës së kontratës së qirasë të paguajë edhe pjesën prej 2,044.89 Euro për muaj.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e transferit të qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në faktet si në vijim.

Kërkesa e palës është pranuar me datë 22.07.2025, protokolluar me nr. 35724, e parashtruar nga N.T.P. De Bona Auto, përfaqësuar nga z. Flamur Kelmendi, përmes së cilës kërkohet që menaxhimi i hapësirës së parkingut sipërfaqësor (para hyrjes kryesore të hotelit), të cilën aktualisht e menaxhon në bazë të kontratës ekzistuese të qirasë, të transferohet te subjekti ADV Facility Management L.L.C, përfaqësuar nga z. Granit Gashi. Kërkesa është e bazuar në marrëveshjen për ndarje të menaxhimit, të lidhur ndërmjet dy palëve më datë 22.07.2025, dhe ka për qëllim efikasitetin operacional dhe financiar në menaxhimin e hapësirave të ndara fizikisht dhe funksionalisht (parking nëntokësor dhe parking sipërfaqësor). Kërkesa për transferim mbështetet në marrëveshjen për ndarje të menaxhimit të parkingut, të lidhur më datë 22.07.2025, ndërmjet palëve të interesuara, dhe ka për qëllim ndarjen funksionale të menaxhimit të hapësirave për rritje të efikasitetit dhe përgjegjësisë në ofrimin e shërbimeve..

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi aktual ka një kohë të gjatë që është qiramarrës dhe deri tek borxhi i lartë ka ardhur si pasojë e vështirësive financiare të papritura për të



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-230/45

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023,), Rregullorja Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 2.5 i Kontratave të Qirasë të nënshkruara në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Tregu" dhe parashtruesve të këtyre kërkesave, 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për transferimin e kontratave të qirasë tek NSh Tregu
- a) Nga Burim Sfishta si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 15A, Tregun me Shumicë (Tekstil), me sipërfaqe prej 136 m², në emër të Power Plus SH.P.K., me numër unik identifikues 810122721, përfaqësuar nga Osman Sfishta, në shumën prej 266.00 €/muaj;
 - b) Nga Agim Mustafa si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 164, 165, Tregu me Shumicë (Tekstil), me sipërfaqe të përgjithshme n/a, në emër të QENDRIMI A.B.Q SH.P.K., me numër unik identifikues 812260438, në shumën prej 80.00 €/muaj;
 - c) Nga Shaip Stublla si qiramarrës i tokës afariste nr. 172 në Tregun me Shumicë (Tekstil), me sipërfaqe prej 50 m², në emër të Graniti XHZH SH.P.K., përfaqësuar nga Xhafer Zhegrova, me nr. personal 1015312153, në shumën prej 150.00 €/muaj;
 - d) Nga Afrim Berisha si qiramarrës i tokës afariste nr. 69 në Tregun me Shumicë (Tekstil), me sipërfaqe prej 14 m², në emër të Fidan Berisha, me nr. personal 1170317064, në shumën prej 40.00 €/muaj;
 - e) Nga Aurora Jahja si qiramarrës i tokës afariste nr. 190 në Tregun me Shumicë (Tekstil), me sipërfaqe prej 175 m² dhe sipërfaqe shtesë (terracë) prej 24 m², gjithsej 199 m², në emër të Auron Jahja B.I., me nr. personal 1172717159, në shumën prej 705.00 €/muaj;
 - f) Nga Januz Beqiri si qiramarrës i tokës afariste nr. 1/A në Tregun me Shumicë (Tekstil), me sipërfaqe prej 182 m², në emër të OZA MIX SH.P.K., përfaqësuar nga Ilmi Beqiri, me nr. personal 1010605675, në shumën prej 361.00 €/muaj;
 - g) Nga HEKRARIA TE LUANI SH.P.K., përfaqësuar nga Luan Xheladini, si qiramarrës i njësive afariste nr. 7 dhe nr. 12 në Tregun me Shumicë (Tekstil), me sipërfaqe prej 48.5 m², në emër të Gzim Limani, me nr. personal 1015122001, në shumën prej 96.13 €/muaj.
- II. Para lidhjes së aneks kontratave të qirasë të transferuara tek personat e lartcekur dhe ndërrimit të emrit, Qiramarrësit aktual do të jenë të obliguar të paguajnë borxhin e papaguar, ose në të kundërtën do të ndërmirën të gjitha veprimet ligjore për inkasimin e borxhit të papaguar dhe lirim të hapësirave:
- a) Burim Sfishta, si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 15A, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek Power Plus SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 245.71€/neto;
 - b) Agim Mustafa, si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 164, 165, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek QENDRIMI A.B.Q SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 73.90€/neto;
 - c) Shaip Stublla, si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 172, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek Graniti XHZH SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 277.12€/neto;
 - f) Januz Beqiri, si qiramarrës i tokës afariste të identifikuar me nr. 1/A, para bartjes së kontratës së qirasë (ndryshimit të emrit) tek OZA MIX SH.P.K., është i obliguar të paguajë borxhin e papaguar në shumën prej 2,000.80€/neto;

MH -



III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e transferit të qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim.

Veprimtaria e NSh Tregu konsiston në menaxhimin e tregjeve dhe inkasimin e të hyrave nga qiradhënia e mjediseve biznesore në hapësirat e Tregut. Ndërmarrja Tregu (në likuidim) menaxhon 3 tregjet e qytetit të Prishtinës:

1. Tregu i Gjellbër
2. Tregu në Ulpianë
3. Tregu në Zonën e vjetër Industriale në Prishtinë

1. Më datë 25.06.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26622/2025, e parashtruar nga Burim Sfishta, me nr. personal 1014268371 përmes së cilës kërkohet që sipërfaqja e shfrytëzuar deri më tani nga Burim Sfishta të transferohet në emër Power Plus SH.P.K., përfaqësuar nga Osman Sfishta. Sipas kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 54606/2024, bëhet fjalë për tokën afariste nr. 15/A, me qira mujore prej 266.00€.
2. Më datë 25.06.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26623/2025, e parashtruar nga Agim Mustafa, me nr. personal 1170785998 përmes së cilës kërkohet që sipërfaqja e shfrytëzuar deri më tani nga Agim Mustafa të transferohet në emër QENDRIMI A.B.Q SH.P.K., përfaqësuar nga Agim Mustafa. Sipas kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 47392/2023, bëhet fjalë për tokën afariste nr. 164, 165, me qira mujore prej 80.00€.
3. Më datë 25.06.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26624/2025, e parashtruar nga Shaip Stublla, me nr. personal 2019929607 përmes së cilës kërkohet që sipërfaqja e shfrytëzuar deri më tani nga Shaip Stublla të transferohet në emër Graniti XHZH SH.P.K. Sipas kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 47422/2023, bëhet fjalë për tokën afariste nr. 172, me qira mujore prej 150.00€.
4. Më datë 02.07.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26646/2025, e parashtruar nga Afrim Berisha, me nr. personal 1001095800 përmes së cilës kërkohet që sipërfaqja e shfrytëzuar deri më tani nga Afrim Berisha të transferohet në emër Fidan Berisha. Sipas kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 47402/2023, bëhet fjalë për tokën afariste nr. 69, me qira mujore prej 40.00€
5. Më datë 02.07.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26647/2025, e parashtruar nga Aurora Jahja, me nr. personal 1172717167 përmes së cilës kërkohet që sipërfaqja e shfrytëzuar deri më tani nga Aurora Jahja të transferohet në emër Auron Jahja B.I. Sipas kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 53365/2024, bëhet fjalë për tokën afariste nr. 190, me qira mujore prej 705.00€
6. Më datë 17.07.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26712/2025, e parashtruar nga Januz Beqiri, me nr. personal 1174147724 përmes së cilës kërkohet që sipërfaqja e shfrytëzuar deri më tani nga Januz Beqiri të transferohet në emër OZA MIX SH.P.K. me numër unik identifikues 812020577, përfaqësuar nga Ilmi Beqiri, me nr. personal 1010605675 sipas kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 56494/2025, bëhet fjalë për tokën afariste nr. 1/A, me qira mujore prej 361.00€.
7. Më datë 17.07.2025, është pranuar kërkesa me nr. protokoli 26711/2025, e parashtruar nga HEKRARIA TE LUANI SH.P.K, përfaqësuar nga Luan Xheladini, me nr. personal 1010604644, përmes së cilës kërkohet që një pjesë e sipërfaqes së shfrytëzuar deri më tani nga HEKRARIA TE LUANI SH.P.K të transferohet në emër të Gzim Limanit, me nr. personal 1015122001.
Në bazë të kontratës ekzistuese të qirasë me nr. protokoli 56487/2025, bëhet fjalë për tokën afariste Depo nr. 7 (me sipërfaqe prej 34.5 m²) dhe Kioska nr. 12 (me sipërfaqe prej 14.0 m²), me sipërfaqe të përgjithshme prej 48.5 m², për të cilat qiraja mujore është 96.13 €.
Pas kësaj ndarjeje, HEKRARIA TE LUANI SH.P.K do të vazhdojë të shfrytëzojë sipërfaqen prej 90.8 m², për të cilën qiraja mujore e rregulluar do të jetë 179.70 €.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratave të Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke ndikuar pozitivisht në rritjen e fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Në këtë rast duhet të kemi parasysh, siç është diskutuar edhe më parë, se NSh Tregu është me karakter specifik dhe hapësirat e vendosura në tokën afariste janë të ndërtuara nga vetë qiramarrësit. Për rrjedhojë, lejohet transferimi i kontratave të qirasë edhe në rastet kur nuk ka lidhje familjare ndërmjet qiramarrësit aktual dhe


Nuk është paraparë ndonjë kufizim për transferim të kontratave të qirasë, siç mund të jetë që transferimi të bëhet vetëm ndërmjet familjarëve ose partnerëve afaristë, as në këto Kontrata të Qirasë. Kushti i vetëm i domosdoshëm është pëlqimi nga ana e AKP-së.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë pad pranë Komës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 qershor 2025



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit




Nr. Ref. BD-230/46

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023,), Rregullorja Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokoli 14647/2018 në mes të "NSh Univerzal", Leposaviq dhe Borivoje Barac, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin e objektit- Lokalit afarist nr. 5 në Rr. 24 Novembar pn, Komuna Leposaviq me sipërfaqe prej 89.95 m2, me qira mujore prej 150.00 € për asetin e NSh Univerzal" MIT051.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e transferit të qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim.

Pala Borivoje Barac është Qiramarrës i Lokalit afarist nr. 5 në Rr. 24 Novembar pn, Komuna Leposaviq me sipërfaqe prej 89.95 m2 që nga dt. 01.10.2018 e tutje. Ky aset ka hyrë në qiradhënie përmes tenderit publik. Më 11.06.2025 Zyra Rajonale e Mitrovicës ka pranuar shkresën me nr. Prot: 5572/2025, nga personi fizik Borivoje Barac i cili kërkon që të bëhet ndërrimi i qiramarrësit nga "Borivoje Barac" tek "Stari Leskovac d.o.o" me përfaqësues ekzekutiv Borivoje Barac.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi aktual ka një kohë të gjatë që është qiramarrës dhe deri tek borxhi i lartë ka ardhur si pasojë e vështirësive financiare të papritura për të

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-230/47

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023,), Rregullorja Nr. 03/2025 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Neni 2.5 marrëveshja e qirasë nr. 14646, midis Agjencisë së Privatizimit të Kosovës dhe Igor Lazarevic, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 korrik 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë për shfrytëzimin Ndërtesa e NSh Lux, me një sipërfaqe prej 120 m², me çmimin e qirasë mujore në shumën prej 269.72 eurosh, e vendosur në kompleksin Zubin Potok, komuna e Zubin Potokut.
- II. Pala është e detyruar ta shlyejë borxhin deri në zero përpara nënshkrimit të kontratës së re.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e transferit të qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim.

Pala Igor Lazarevic është qiramarrës i lokalit MIT039 Lux në Zubin Potok me një sipërfaqe prej 120 m², duke filluar nga 01/12/2018. Aneksi i fundit i kontratës së qirasë është lidhur më datë 07.03.2025. Më 26.06.2025 Zyra Rajonale e Mitrovicës ka pranuar shkresën me nr. Prot: 5618/2025, nga personi fizik Igor Lazarevic, i cili kërkoi ndryshimin e emrit të qiramarrësit nga personi fizik Igor Lazarevic në personin juridik AGRO LAZAREVIC D.O.O., drejtor ekzekutiv i të cilit është Igor Lazarevic.

Sipas vlerësimit të AL-së, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësi aktual ka një kohë të gjatë që është qiramarrës dhe deri tek borxhi i lartë ka ardhur si pasojë e vështirësive financiare të papritura për të

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 korrik 2025


